

Living

EDITORIAL

*Aleati më i fortë
në betejën tuaj
kundër **celulitit**.*

*Në Repeat Medical Clinic,
mjeshtri i frekuencave
DR. **Emmanouil A.
Lazaridis!***

Dr.

“Miku juaj më i mirë – Aleati më i fortë në betejën tuaj kundër **celulitit.”**

Emmanouil

A. Lazaridis:

Mjeshtri i frekuencave!

Nga: **Kostandin Feshti**


Fotografia: **Renato Hyselli**

Dizajn Grafik: **Kostandin Feshti**

Në vendin tonë e sidomos vitet e fundit, duket sikur kujdesi ndaj vetes, nisur nga regjimi ushqimor, stili i jetesës e deri tek trajtimet përkatëse për trupin e fytyrën, është bërë një temë bisede shumë e gjerë, kjo stimuluar dhe nga alternativat e shumta që po na serviren këtë periudhë. Por, siç ndodh shpesh, një diskutim i tillë shoqërohet dhe me një hulumtim mbi cilësinë e asaj që po të ofrohet në formën e një trajtimi, regjimi apo elementi të caktuar, ashtu si dhe lidhur me profesionalizmin e atij apo asaj që po ta ofron. Në rastin tonë, këtë shkrim nuk ja kemi dedikuar pa asnjë arsye një mjeku ndërkombëtar, i cili është i specializuar për një teknikë specifike, e cila as nuk konsiderohet një ndërhyrje e mirëfilltë, por që ndihmon në eliminimin total të celulitit, pjesë e trupit tuaj.

Të gjithë e dimë që për zonjat e zonjushat, dhe jo vetëm në fakt, celuliti është një nga komplekset më të mëdha lidhur me trupin e dukjen e tij, e që për të cilin njerëzit janë gjithmonë e më tepër në kërkim të metodave e trajtimeve për ta, në mos zhdukur, për ta minimizuar prezencën e tij në trup. Kjo sa mund të bëhet nëpërmjet **trajtimit me gjilpërën e imët ekelrodë (Spherofill Cell)**, të mundësuar në klinikën e njohur **“Repeat Medical Clinic”**, doktori Lazaridis thekson se gjysëm e punës e mbart pikërisht pacienti mbas kryerjes së procedurës, me kujdesin ndaj ushqimeve, kohës së konsumimit të vakteve, hidratimin e trupit në maksimum dhe eliminimin sa më të madh të alkoolit si pjesë e rutinës së ditëve. Jo më kot e cilësuam pak më lart si një trajtim estetik që madje, as nuk mund të quhet një ndërhyrje mini-evazive, pasi koha dhe mënyra e realizimit, janë të shkurtra e të thjeshta në maksimum. Vetë doktori as nuk aplikon një krem mpirës në vendin ku gjilpëra me elektrodë do të depërtojë lëkurën për të këputur fibrozën në trupin tuaj, me një temperaturë 38.5° Celsius, por thjesht vendos një paketë me akull sa për të ftohur pak lokacionin e shenjuar.

Rezultatet janë të menjëhershme.



Doktori Emmanouil A. Lazaridis, me origjinë greke është një ndër emrat më të njohur në fushën e tij, jo vetëm në Greqi, por gjithashtu në Zvicër, ku ka dhe një klinikë të tijën “*Swiss Beauty Medical Center*”, në Itali, Francë, e tanimë dhe në Shqipëri, ekskluzivitet i “*Repeat Medical Clinic*”. Me një karrierë të gjatë e rezultate plot sukses, doktori është një ndër të pakët trajnues të kirurgëve plastikë në Milano dhe ajo karakteristikë me të cilën ai krenohet më së shumti është empatia e tij kundrejt pacientit.



PARA



PAS

Gjatë bisedës me të, lidhur me trajtimet për mirëmbajtjen e lëkurës e fytyrës, trendeve të tyre e të gjitha me rradhë, Dr. Lazaridis shprehet:

“Unë nuk kryej asnjë ndërhyrje e trajtim, për të cilin nuk shoh nevojë tek pacienti që kam përballë. Zonjat kanë një obsesion të pashmangshëm për t’u përkujdesur për veten, e shpesh kërkojnë më shumë seç duhet të marrin, e unë jam këtu për t’u thënë “jo”. Një mjek i mirë duhet të jetë gjithashtu dhe një psikolog i mirë. Unë mundohem të prek jo vetëm trupin, por dhe shpirtin e tyre, për të kuptuar me të vërtetë se çfarë unë si doktor duhet të bëj me rastin që kam në dorë. Nëse punët kryhen vetëm për para, ato asnjëherë nuk rezultojnë të suksesshme apo jetëgjata, e me këtë standard nuk kam bërë kurrë kompromise në jetën e karrierën time”.

“Ajo çfarë unë di të them është se po i afrohem fundit të një epoke volumi të panevojshëm në fytyrë, duke mbushur çdo cep apo duke ngrirë çdo muskul deri në pikën ku vetë muskuli nuk i përgjigjet një mpirësi, siç është botoksi. Në klinikën time trajtimet konsistojnë në përkujdesjen e lëkurës me procedura që përmbajnë vitamina nga më të ndryshmet, e që stimulojnë prodhimin e kolagjenit nga vetë trupi, siç është dhe kombinimi i ngritjes minimale të fytyrës nëpërmjet trajtimit me lazer, shoqëruar më pas me mesotherapy-në me elementet më të mira nga Miami. Një kombinim i tillë garanton një stimulim 600% të kolagjenit në trup dhe 300% të elastinës. Jo detyrimisht botoks, jo detyrimisht filler, thjesht një terapi hibride. Ngritja e fytyrës me fibër optike është e ardhmja. Pa patur nevojë për muaj rikuperimi mbulur me fasha me trashësi nga më të ndryshmet. Pa patur nevojë për merakosje për të ndërruar fjetet nën lëkurë e çdo ankth që shoqëron procedurat e vjetra, që qartazi nuk japin më rezultatet që njerëzit tanimë po kërkojnë të kenë.”





PARA



Living EDITORIAL

PAS

Doktori e quan veten Mjeshtër të Frekuencave, një titull ky i dhënë si nga kolegët e tij, ashtu dhe nga pacientet, të cilat janë të shumta në numër, të kënaqura me punën efikase që doktori kryen.

Kur dëgjon këto fjalë nga një doktor i vlerësuar në punën e tij, mendja të shkon menjëherë tek shembujt që proklamohen në media e rrjete sociale tek fenomeni i frikshëm i ngjashmërisë së fytyrave në atë pikë, ku unikaliteti i tipareve duket thajse si një koncept i shekullit të shkuar. Mendon se si në një moment të dytë ke menduar se kështu do të jetë gjithmonë e se duhet ta pranojmë situatën për atë që është. Vjen një moment, ku situata ndryshon, ku natyraliteti është përsëri qëllimi në vetvete dhe ajo që vlerësohet më shumë. Sigurisht, pika e lartpërmendur se prezenca e një profesionisti në jetën tënde qëndron më shumë seç çdo gjë tjetër, e se nganjëherë mund të biem lehtësisht pre e ideve tona të keqmenduar e tendencave të marketuara shumë dhe është ky momenti kur na duhet dikush, ekspert i fushës, që të na thotë thjesht një “jo”, e të na ofrojë pikërisht atë për të cilën mund të kemi nevojë. Na duhet Dr. Emmanouil A. Lazaridis.